



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 05.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.05.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Marisa" SH.P.K., e dt.06.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 02.05.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **02.05.2025;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K., me dt.06.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Radoniqit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2207-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-029-521,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me Certifikatën për siguri dhe shëndet në punë të prezantuar nga Operatori i rekomanduar për kontratë, është i pa bazuar, sepse i njëjti ka prezantuar certifikatë të lëshuar nga NMA sh.p.k., e cila është e licencuar nga MPMS-ë, dhe në këtë pikë plotëson kërkesën e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë;

Pretendimi juaj lidhur me kontratat e natyrës së ngjashme, nuk qëndron sepse Autoriteti kontraktues nuk ka caktuar se sa kontrata të prezantohen, mjafton që kontrata / kontratat e prezantuara nga operatori ekonomik të plotësojnë kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi juaj lidhur me listën e punëtorëve të angazhuar, nuk qëndron sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e stafit teknik, listën e stafit profesional dhe listën e ATK-së, me çka plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Sa i përket pretendimeve të juaja për Operatorin ekonomik "Asfalti" sh.p.k., Autoriteti kontraktues nuk do të lëshohet në shqyrtimin e tyre, sepse të njëjtin Autoriteti kontraktues e ka shpallur si të pasuksesshëm;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;

